



“Mendoj se ëndrrat tuaja janë përputhur te shtatëshja e fundit. Ai që dëshiron ta kërkojë Natën e Kadrit, le ta kërkojë në shtatëshen e fundit.”

Ibn Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) tregon: “Disa shokë të Profetit ﷺ panë në ëndërr se Nata e Kadrit është në shtatë netët e fundit. I Dërguari i Allahut ﷺ u tha: “Mendoj se ëndrrat tuaja janë përputhur te shtatëshja e fundit. Ai që dëshiron ta kërkojë Natën e Kadrit, le ta kërkojë në shtatëshen e fundit.”

[Sahih] [Muttefek alejhi]

Disa burra nga shokët e Profetit ﷺ panë në ëndërr se Nata e Kadrit është në shtatë netët e fundit të Ramazanit. Atëherë Profeti ﷺ tha: Po shoh se ëndrrat tuaja janë përputhur, se ajo është në shtatë netët e fundit të Ramazanit. Prandaj, kush e kërkon atë dhe është i përkushtuar për ta arritur, le ta kërkojë me zell dhe duke shtuar veprat e mira, sepse ajo ka më shumë gjasa të jetë në shtatë netët e fundit, të cilat fillojnë nga nata e 24-tër, nëse Ramazani është tridhjetë ditë, ose nga nata e 23-të nëse muaji është njëzetënëntë ditë.

<https://sunnah.global/hadeeth/sq/show/4545>

